

VENDIM
Nr.466, datë 29.6.2011

PËR KALIM FONDI NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TEK OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi prej 14 057 607 (katërmbëdhjetë milionë e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatë) lekësh, parashikuar në buxhetin e vitit 2011 për Ministrinë e Drejtësisë, në programin “Sistemi i burgjeve”, zëri “Fonde për përballimin e kostove lokale për investimet e huaja”, të transferohet në llogarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të përdoret prej tij për zhvendosjen e linjës së tensionit të lartë, e cila pengon vazhdimin e punimeve për realizimin e projektit “Ndërtimi i qendrës së paraburgimit dhe burgut, Fier”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha